



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVA



KOMUNA E PEJËS / MUNICIPALITY OF PEJA / OPŠTINA PEĆ

KUVENDI KOMUNAL PEJË

Komiteti për Politikë e Financa

I.Numër: 01-060/01-97590

Pejë, datë: 16 Shtator 2022



PROCESVERBAL

Nga takimi i VIII-të i Komitetit për Politikë e Financa i KK-së Pejë, mbajtur më 16 Shtator 2022, në ora 13:00.

Takimi u mbajt në sallën e Komitetit për Politikë dhe Financa.

Pos anëtarëve të komitetit, në këtë takim prezantojnë: Kryesuesi z. Rexhep Kurtbogaj, z. Jeton Abazaj Drejtor i financave, z. Avni Gashi, Udhëheqës i Sektorit të Kuvendit, znj. Donjeta Morina Asistente Administrativ dhe përfaqësuesit e ZIP-it.

Takimin e hapi dhe e kryesoi, kryesuesi z. Rexhep Kurtbogaj, i cili konstatoj se një anëtar nuk është prezent. Pastaj kryesuesi e hapi diskutimin për rendin e ditës, ku i sqaroi të gjitha pikat të cilat janë vendosur në renditjen e ditës.

Unanimisht nga të gjithë prezent u miratua ky:

Rendi i Ditës

- (1) Pjesëmarrja në takim e anëtarëve të komitetit dhemungesa.
- (2) Shqyrtimi i draf-buxhetit të Komunës së Pejës 2023-2025.
- (3) Shqyrtimi draft - Planit të Punës së Kuvendit 2023.
- (4) Shqyrtimi i draft - Kalendarit të takimeve të Komitetit për Politikë e Financa dhe Kuvendit 2023.
- (5) Informat për fillimi i vitit shkollor 2022-23.
- (6) Pyetjet dhe propozimet lidhur me punën e Komunës, të ngritura nga anëtarët, në atë Rënditje siç janë pranuar.

I. Pjesëmarrja në takim e anëtarëve të komitetit dhe mungesa.

Në këtë takim mungoj z. Berat Ganiqi.

II.Shqyrtimi i draf-buxhetit të Komunës së Pejës 2023-2025

z. Jeton Abazaj, buxheti është pak me ndryshime jena mundu mi specifiku dhe me ceke vendet se ku kanë me u be investimet, sidomos në keto tri fusha janë të specifikume rrugë, kanale të ujitjes, po presim edhe prej Drejtorisë së Arsimit me na informu se cilat shkolla kanë me u renovu me fondet që janë të parapara. Te materiali që e keni marr sot është një ndryshim është hek shpronësimi si kod dhe është bart si punë publike për arsye se vjet kemi qenë e vetmja Komunë qe e kemi pas shpronësimin si kod të veçant sipas dy udhëzimeve administrative 05/2019 dhe 06/2019 Komunave nuk ju lejohet me pas fond të veçant të shpronësimit por duhet me qene pjese e projektit, e kemi kthy në punë publike edhe me i shpronësu pronat që kalojnë për rreth Lumbardhit, te projekti i Lumbardhit e cekim qe ka me u punu shetitorja dhe qe kemi me i pagu pronat që janë per rreth Lumbardhit per shkak te dy udhëzimeve administrative. Ndryshimet tjera janë te mallrat dhe sherbimet 2024-2025 është dasht me rrit shumën kanë qenë 4.4 milion euro, ne vitin 2023 mallra dhe sherbime janë 4.517 milion euro dhe ne vitin 2024 janë

4.560 milion euro me propozim t'parë i kemi pasur 4.4 milionë të dyja, edhe subvencionet është ndryshimi në vitin 2023 është 800 mijë euro, 2024 është 850 mijë euro dhe viti 2025 është 900 mijë euro. Me 6 vetura të reja që planifikohet të ble edhe 10 të tjera dalin prej përdorimit dhe behen 20 vetura të reja, blerja e kompjuterëve për aftësimin e Qendres së Rekrutimit që është e nevojshme e kemi obligim që 30 kompjutera të jenë prezent për mbajtjen e testeve online. Rregullimi i çështjes së infrastrukturës me Ministri dhe Donator e lojmë si kod të përgjithshëm të kodi i dytë participimi me KFË-në për rehabilitimin e Deponisë së Mbeturinave këtu ka një mundësi deri në Kuvend me pas një ndryshim për të vetmen arsye se Qeveria nuk po e perkrahë këtë projekt. Në këtë projekt ka mu punë, kemi me u zotë që i qesim 3 milionë për tri vjet 2023-2025, me këto do të mundësohet me u zgjidhë problemi për 30 vjet për Deponinë e Sferkes me qene Deponia më e mirë dhe me qene Komuna e parë që e zgjidhim këtë problem, këtu është 8 milionë euro projekti, 3 milionë euro na, 3 milionë euro KFË-ja, dhe 2 milionë euro Participimi për Grantin Stimulues sipas performancës me MAPL, takimin e fundit që ka mbajtur kryetari me ministrin z.Liburn Aliun ai po thotë se ky projekt nuk bëhet deri në Kuvend mbetet si fond nëse nënshkruhet projekti bëhet një punë e mirë nëse jo atëherë terhiqet edhe KFË-ja. Projekti i parë është rregullimi i Lumit pjesa e poshtme veshja me gurë ka filluar nuk përfundon sivejt, e dyta është shpronësimi dhe një pjesë e infrastrukturës për rregullimin e shetitores. Në qytet kanë me u ndërto rrugicat që janë mbet në Kapeshtice dhe disa rrugë rreth Komunes, në fshatra përfshirë edhe Rugovën, ndërtimi i kanalizimit në lagjet Karagaç, 2 Korriku dhe Dardania duhet me intervenuar shkak i rrugës që ka mu ndërto, ndërtimi i ujësjellsave Stankaj, Boge, Shkrel, Pepaj, Shtupeq i Madh, Pepaj, Kuqishtë vazhdojnë, ndërtimi i shtetores "Ibrahim Rugova" është menduar me u vendos në qendër të qytetit afër Komunes, asfaltimi i rrugës Sejnov Gjore projekti i veçant për shkak të vlerës që e ka pas, ndërtimin e ujësjellsit në Lugun e Baranit, infrastruktura në qytet vazhdimi i shetitores, rregullimi i stacionit të autobusave, ndërtimi i strehimoreve për qenat endacak afër Deponisë së Mbeturinave, 60 mijë euro të ndara për trajtimin e qeneve endacak dhe 40 mijë euro për strehimore, ndërtimi i shtepive në fshatin Kosuriq dhe në Jabllanice të vogël. Në Vitomericë vazhdon asfaltimi i rrugëve po ashtu dhe në Bllagaj, Brestovik, Gorozhdevc, Novosellë dhe në Zllapek. Drejtoria e Urbanizimit, është menduar me u zgjidh problemi i kanalit që po vërshon te Furra Husaj. Drejtoria e Shëndetësisë, si projekt ka filluar ndërtimi i QKMF-së në Karagaç është menduar me u ble edhe paisjet, inventarin, aparatura mjeksore, po ashtu renovimi QKMF-së një pjesë e Zahaqit dhe e Poliklinikës dhe është menduar

me u renovu ambullanta në Bogë. Drejtoria për Mirëqenie Sociale: ndërtimi i objektit për përsoneat që nuk kanë strehim. Drejtoria për Kulturë, është faza finale renovimit teatrit edhe 100 mijë euro të tjera e kemi shpalle tenderin fatkeqësisht nuk ka apliku askush, për ngrohje kan apliku na ka mbet qe edhe një pjesë e rregullimit me u perfundu në vitin 2023, rregullimi i Galerisë së Arteve, ndërtimi i fushës në Baran faza finale, instalimin e ngrohjes qendrore dhe ventilimi në sallën e sporteve Karagaç, ndërtimi i palestres në Zahaq, ndërtimi i tribunave në stadiumin e Vitomerices. Emergjencë, blerja e paisjeve për raste emergjente. Drejtoria e Arsimit, ndërtimi i shkollave fillore në fshatra, ndërtimin e sallave të reja, fonde për renovime vjetore për mirëmbajtje e shkollave, si dhe ndertimi i sallave te reja.

z.Labinot Panxha: Ndërtimi i ujësjellësit në Lugun e Baranit mendoj që është i mjaftushem dhe mendoj qe duhet mu përfundu deri ne vitin 2023. Te bursat për student është shumë e vogel 30 mijë euro dhe mendoj qe ish dasht me u rrit kjo shumë, si dhe per ndërtimin e shtepisë në fshatin Kosuriq po ju falenderoj të gjithë juve qe e keni marr seriozisht dhe e keni mbështet ketë projekt. Deshta një pyetje te Sherbimet Ligjore për çka është nda kjo shumë?

z.Jeton Abazaj: Për pagesën e avokatit qe e ka Komuna, pagesa është në baze të një marveshjes të negocijimit e cila është më e ultë se tarifa e Odës Avokatëve.

Unanimisht nga të gjithë anëtarët prezent me rekomandimet që u dhanë i rekomandohet kuvendit për shqyrtim dhe miratim, i draf-buxhetit të Komunës së Pejës 2023-2025

III. Shqyrtimi draft - Planit të Punës së Kuvendit 2023.

Kryesusi Rexhep Kurbogaj: Në seancen e kaluar e kemi formu një komision dhe e kemi mbajt një takim me komisionin, dhe e kemi hap diskutimin publik ashtu siç e shih Statuti dhe Rregullorja e Punes, pikat për planin e punës qe kanë të bëjnë me rendin e ditës disa janë qe e matin aspektin e performances së Komunës që nuk mund te hiqen, por ka edhe pika tjera si raporte informative e hyjn si propozime të Kryesuesit ose mund të ketë ndoni propozim prej Komuniteti i shqyrtojmë dhe i miratojmë.

Znj.Hidajete Nikqi: Ne i jepem rekomandimet tona për dy pika që janë hequr në muaji Shkurt qe të vendosen prap, informatë mbi procesin e legalizimit te objekteve dhe informatë mbi inspektin e ndërtimeve.

Unanimisht nga të gjithë anëtarët prezent me rekomandimet që u dhanë i rekomandohet kuvendit për shqyrtim dhe miratim, draft - Planit të Punës së Kuvendit 2023.

IV. Shqyrtimi i draft - Kalendarit të takimeve të Komitetit për Politikë e Financa dhe Kuvendit 2023.

Kryesusi Rexhep Kurbogaj: Ndryshimi i orarit të takimit të KPF-së nga ora 10:00 në orën 11:00.

Unanimisht nga të gjithë anëtarët prezent i rekomandohet kuvendit për shqyrtim, Shqyrtimi i draft - Kalendarit të takimeve të Komitetit për Politikë e Financa dhe Kuvendit 2023.

V. Informat për fillimi i vitit shkollor 2022-23.

z. Labinot Panxha: Drejtori i Arsimit ish dasht me qenë prezent për të na informuar dhe sqaruar rreth fillimit të vitit të ri shkollor 2022-23.

Unanimisht nga të gjithë anëtarët prezent i rekomandohet kuvendit për shqyrtim, Informat për fillimi i vitit shkollor 2022-23.

VI. Pyetjet dhe propozimet lidhur me punën e Komunës, të ngritura nga anëtarët, në atë Renditje siç janë pranuar:

Nuk ka pasur.

Pjesë e këtij procesverbali është edhe audio incizimi i këtij takimi të Komitetit për Politikë dhe Financa.

Meqë u shqyrtuan të gjitha pikat e rendit të ditës e propozime të tjera nuk pat, kryesuesi z. Rexhep Kurtbogaj e shpalli të mbyllur këtë takim të KPF-së në orën 14:00 h.

Procesmbajtësja,
znj. Donjeta Morina




KRYESUESI,
z. Rexhep Kurtbogaj

